



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

VENDIM

NR. 1, DATË 04. 07. 2013

**PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR SEKTORIAL PËR
GAZSJELLËSIN TRANS ADRIATIK (PROJEKTI TAP)**

Në mbështetje të nenit 5, 6, 8, 32, 34, 36, 37, 39 dhe 70 të Ligjit Nr. 10119, dt. 23.04.2009 "Për Planifikimin e Territorit", i ndryshuar; Ligjit Nr. 116/2013, dt. 15.04.2013 "Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, lidhur me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP), si dhe të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, në lidhje me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP)", (referuar ne kete Vendim si Ligji Nr.116/2013), VKM Nr. 481, dt. 22.6.2011 "Për miratimin e rregullores uniforme të instrumenteve të planifikimit", VKM nr. 459, dt. 16.06.2010 "Për miratimin e standardeve të përbashkëta gjeodezike dhe GIS", VKM Nr.87 dt. 07.02.2012 "Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit", si dhe Vendimit Nr.2, datë 20.12.2012 të Këshillit Kombëtar të Territorit "Për miratimin e projektit TAP si Çështje me Rëndësi Kombëtare në Planifikimin e Territorit";

me propozim të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit,

KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit Kombëtar Sektorial për projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), përfshirë të gjitha shtojcat dhe materialin grafik, si pjesë përbërëse e këtij plani.
2. Plani Kombëtar Sektorial për projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP) do të jetë objekt rishqyrtimi mbas 10 vjetësh nga data e miratimit të tij ose edhe më herët nëse konsiderohet e nevojshme për zhvillimet e mëtejshme të Projektit TAP dhe nëse do të paraqitet kërkesë nga Investitori i Projektit për ndonjë ndryshim të mundshëm të këtij plani.

3. Çdo instrument planifikimi i nivelit kombëtar, vendor, ndërvendor apo i integruar, që do të ndërmerret në të ardhmen nga autoritetet planifikuese përgjegjëse, i cili prek zonën e zhvillimit të projektit TAP, duhet të marrë në konsideratë Planin Kombëtar Sektorial për projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP).

4. Këshilli Kombëtar i Territorit në zbatim të Ligjit Nr. 10119 dt. 23.04.2009, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore përkatëse do të miratojë për Investitorin e projektit TAP një leje zhvillimore komplekse, e cila konsiderohet e njëjtë me Lejen e Infrastruktures, në kuptim të nenit 5.4 dhe të nenit 28.6, të "Marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, lidhur me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP)", të ratifikuar me Ligjin Nr. 116/2013.

4.1 Për miratimin e Lejes Zhvillimore Komplekse nga KKT, Investitori i projektit TAP do pranohet të paraqesë në METE, përveç dokumentacionit me të dhënat administrativo/juridike të cilat kërkohen për aplikim, dokumentet e mëposhtëm:

- i. projekt-idenë e zhvillimit dhe skemën e plotë të shtrirjes së projektit (plan-vendosjen e strukturës), e shoqëruar me treguesit kryesorë teknikë dhe me sipërfaqet konkrete të shesheve ku do të bëhen ndërtimet apo ndërhyrjet në territor;
- ii. informacion mbi marrëdhëniet e pronësisë dhe përdorimin e tokës për sipërfaqet që preken nga projekti;
- iii. kalendarin e fazave të zhvillimit, në kuptim të Ligjit Nr. 116/2013;
- iv. përlllogaritjen paraprake dhe kalendarin e pagesës së takses së impaktit mbi infrastrukturën në përputhje me seksionet dhe fazat e zhvillimit të projektit;
- v. lejen mjedisore.


4.2 Lëshimi i Lejes Zhvillimore Komplekse nga METE dhe ekzekutimi i saj, do të bëhet në mënyrë graduale sipas seksioneve dhe fazave të ndryshme të zhvillimit të sistemit të gazsjellësit TAP. Dokumenti administrativ teknik i Lejes Zhvillimore Komplekse do të lëshohet nga METE, për do fazë ose seksion, në përputhje me kërkesat e Investitorit të projektit TAP, pas paraqitjes së dokumentacionit përkatës lidhur me fazën ose seksionin në fjalë, të përcaktuara në dispozitat përkatëse të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit", i ndryshuar, akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji si dhe në përputhje me rregullimet specifike të parashikuara në Ligjin Nr. 116/2013.

5. Te gjitha autoritetet e ngarkuara me ligj, në nivel qendror apo vendor, në përputhje me kompetencat e tyre ligjore mund të japin leje (psh. leje minerare, koncesione, infrastrukture publike, apo private, etj) brenda korridorit prej 500 m të projektit TAP, të shpallur "zonë kombëtare" me Vendim nr. 2, datë 20.12.2012 të Këshillit Kombëtar të Territorit, vetëm pasi kanë marrë në konsideratë Planin Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik (TAP) në tërësi dhe rregullat e standardet teknike të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe ato të prezantuara në këtë plan, në veçanti.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

SALI BERISHA




ZËVENDËS KRYETAR I KKT

SOKOL OLLDASHI

MINISTËR I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT




SEKRETARE E KKT

KREUZA LEKA

DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

